



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

I.AGJ.nr.1/2024-2
Janar 2024

RAPORTI I PUNËS – 2023
PËR: Këshillin Gjyqësor të Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
KRYETARJA
SHPRESA EMRA
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

JANAR 2024

PËRMBAJTJA

PJESA E I-rë

Përmbledhje ekzekutive

I. Informata të Përgjithshme për Gjykatën Themelore në Prizren

- 1.1 Raporti i Përgjithshëm dhe krahasimi i tremujorëve për performancën e Gjykatës
- 1.2 Gjykata Themelore – Dega në Suharekë
- 1.3 Gjykata Themelore – Dega në Dragash
- 1.4 Raporti mbi moshën e lëndëve në pritje
- 1.5 raporti mbi dështimin/anulimin e seancave Gjyqësore
- 1.6 Raporti për Gjyqtarët dhe Stafin Administrativ
- 1.7 Raporti mbi lëndët për procedurat SMIL - SQEP



PJESA E II-të

2. Aktivitet e Gjykatës Themelore në Prizren

- 2.1 Ri funksionalizimi i objektit të Gjykatës për Divizionin Civil
- 2.2 Aktivitet e zbatuara nga plani i punës së KGJK-së.
- 2.3 Qasja në Gjykatë – Takimet me Qytetarët
- 2.4 Raporti mbi publikimin e vendimeve Gjyqësore
- 2.5 Raporti mbi rastet disiplinore
- 2.6 Raporti për trajtimin e rasteve të ndërmjetësimit
- 2.7 Raporti mbi trajtimin e rasteve me interes publik

PJES E III-të

3. Përfundimi – Të arriturat për vitin 2023



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

Bazuar në nenin 14 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit për Gjykata, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren, paraqet raportin e rregullt të punës për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2023.

PJESA E I-rë

Përmbledhje ekzekutive

Raporti i Punës për vitin 2023 paraqet dokumentin bazë për aktivitetin e Gjykatës Themelore në Prizren dhe degët e saj Suharekë dhe Dragash.

Ky raport prezanton aktivitetet e gjykatës, nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit 2023, në të cilin përfshihet veprimtaria, të arriturat dhe sfidat me të cilat është përballur gjykata, gjatë kësaj periudhe.

Në pjesën fillestare, raporti paraqet performancën e Gjykatës Themelore në Prizren dhe degëve Suharekë dhe Dragash dhe krahasimin e performancës në periudha të ndryshme kohore (tremujori i I-rë, dhe kështu me radhë). Gjithashtu, në këtë pjesë në raport paraqiten informata për lëvizjen e gjyqtarëve (avancime, pensionime), gjendjen aktuale me gjyqtarë dhe nevojat e Gjykatës Themelore në Prizren dhe degëve në Suharekë dhe Dragash. Gjithashtu, në këtë pjesë përmban edhe gjendjen me stafin administrativ, nevoja të gjykatës për plotësimin e vendeve të punës dhe mungesën e stafit administrativ.

Në vijimësi raporti përmban të dhënat për aktivitetet e gjykatës dhe të Kryetares së gjykatës, pastaj qasja e palëve në gjykatë, transparenca dhe komunikimi me publikun, trajtimi i rasteve disiplinore në bazë të ankesave të qytetarëve, dhe trajtim i rasteve me interes për publikun.

Në fund të raportit janë paraqitur të arriturat për vitin 2023 dhe sfidat që parashihen për vitin 2024 që ndërlidhen me objektin e gjykatës dhe stafin e saj.

1. Informata të Përgjithshme për Gjykatën Themelore në Prizren

Më lejoni që menjëherë në fillim të ju informoi se Gjykata Themelore në Prizren, vitin 2023 e ka përmbyllur me sukses jo vetëm në aspektin e statistikave dhe zgjidhjes së lëndëve, por ka pasur ndryshime dhe ri organizmit të cilat kanë rezultuar me punë efikase, kualitative, dhe shërbime në kohë për palët dhe qytetarët që marrin shërbime në gjykatë.

Viti 2023 është karakterizuar me plotësimin e pozitave të gjyqtarëve dhe bashkëpunëtorëve profesional, për dallim nga viti 2022, por sfidë mbetet menaxhimi dhe plotësimi i vendeve të punës për degët e gjykatës Suharekë dhe Dragash. ndërsa sfidë që vazhdon të jetë edhe sot është numri i të punësuarve në administratë dhe mos plotësimi i këtyre pozitave me kohë.

Pos sfidave të përditshme, viti 2023 ka shënuar edhe sukseset për Gjykatën Themelore në Prizren, duke filluar nga riorganizimi i stafit, rekrutim i bashkëpunëtorëve profesional, riorganizimi dhe ri funksionalizimi i objektit përcjellës ku tashmë funksionon Divizioni Civil, rritja efikasiteti në tremujorin e 2-të dhe të 3-të, ashtu që në periudhën Janar – Shtator, Gjykata Themelore në Prizren ka qenë gjykatë me efikase në nivel vendi.

Kryetarja e gjykatës ka nën mbikëqyrje direkt ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale dhe efikasiteti i këtyre zyreve është mbi 100%. Zyra për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe ekzekutimet civile, në vazhdimësi paraqesin raporte tre mujore për punën dhe aktivitete tek Kryetarja e gjykatës dhe këto raporte bashkëngjiten në raporte tre mujore të rregullta që raportohen në KGJK të cilat janë miratuara në mbledhjet e KGJK-së. Në muajt Nëntor dhe Dhjetor, është duke u punuar intensivisht për barazimin e lëndëve dhe mbylljen e lëndëve edhe në SMIL.

Gjykata Themelore në Prizren, përmes organizimit të brendshëm ka shtuar numrin e referentëve në lëminë civile me qëllim të evitimit të volumit të madh të lëndëve të pranuar dhe lëndëve që duhet proceduar sipas mjeteve të goditjes ndaj vendimeve të shkallës së parë. Vazhdimisht përcillet puna e referentëve sa i përket dërgimit të lëndëve me ankesë në gjykatat e shkallëve më të larta. Është shtuar kujdesi që të respektohen afatet ligjore sa i përket lëndëve me ankesë. Shefi i ZML-së, mbikëqyrësi i referentëve dhe administratorja, në vazhdimësi monitorojnë punën dhe ecurinë e procesit, ashtu që në fund të vitit 2023 nuk kemi ndonjë ankesë apo raste ku shfaqen pengesa lidhur me këtë proces.

Shpërndarja e barabartë e punës, përmasimi i gjendjes në arkiva dhe aktivitetet të tjera, që kanë rezultuar drejtpërdrejt në efikasitet të punës dhe në përmasimin e besueshmërisë tek publiku.

1.1 Raporti i përgjithshëm dhe statistikor i gjykatës për vitin 2023

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga sistemi SMIL dhe statistikave të përgjithshme, Gjykata Themelore në Prizren, në vitin 2023 ka qenë gjykata më e suksesshme në nivel shtetëror duke treguar efikasitet të përgjithshëm prej 102% të zgjidhjes së lëndëve.

Të gjithë departamentet dhe divizionet, përjashtimisht lëndë kontestimore, gjykata ka treguar një efikasitet mbi 100%.

Ndarë në departamente si në vijim:

Departamenti për Krime të Rënda: në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 158 raste, ndërsa gjatë vitit 2023 janë pranuar në punë 106 raste të reja. Gjatë vitit 2023 janë zgjidhur 121 raste apo me efikasitet prej 114%.

Ky departament ka një efikasitet të mirë dhe trajtimi i rasteve në aspektin kohor në këtë departament (kur nuk ka pengesa ligjore) është brenda një afati shumë të mirë, pasi që nuk ka vonesa në caktimin e shqyrtimeve fillestare dhe shqyrtimeve gjyqësore. Në këtë departament janë duke u trajtuar edhe 11 lëndë të cilat janë pranuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë

Departamenti për të Mitur: në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 134 raste, ndërsa gjatë vitit 2023 janë pranuar në punë 100 raste të reja. Gjatë vitit 2023 janë zgjidhur 131 raste apo me efikasitet prej 131%.

Angazhimi i dy (2) gjyqtareve në këtë departament ka treguar rritje të efikasiteti dhe edhe gjatë vitit 2024 nuk do të ketë ndryshime sa i përket numrit të gjyqtareve në këtë departament.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal: në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 2,465 raste, gjatë vitit 2023 janë pranuar në punë 1.386 raste të reja. Në vitin 2023 janë zgjidhur 1,539 raste apo me efikasitet prej 111%.

Ky departament në vazhdimësi ka një efikasitet të ngjashëm, ndërsa mbetet që gjatë vitit 2023 të ketë angazhim më të madh në zgjidhjen e rasteve me ndërmjetësim.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil:

Në lëminë **kontestimore** në fillim të vitit 2023 janë trashëguar 7,462 lëndë, gjatë vitit 2023 janë pranuar 5,486 (apo mbi 1,300 lëndë më shumë se në 2022).

Kjo është sfidë jashtëzakonisht e madhe menaxhimi i një numri kaq të madh të lëndëve, mirëpo në këtë drejtim konsiderojmë se ky divizion me një angazhim maksimal, ka rritur të menaxhojë në përgjithësi jashtëzakonisht mirë të gjithë procesin e trajtimit të lëndëve, nga pranimi, regjistrimi trajtimi procedural deri në fazën e arkivimit.

Gjatë vitit 2023 janë zgjidhur 3.997 lëndë të natyrës kontestimore, apo me një normë efikasiteti prej 73%. Kjo normë efikasiteti përkundër se mund të duket jo shumë e lartë, janë mbi 1,300 lëndë më shumë të zgjidhura se në vitin 2022.

Sikurse në të gjitha gjykatat në këtë divizion mbetet sfiduese numri i lartë lëndëve në ardhje, mirëpo Gjykata Themelore në Prizren në këtë drejtim ka pasur një organizim të mirë dhe efikasitet të kënaqshëm falë edhe rekrutimit të bashkëpunëtorëve profesional dhe rritjes së numrit të gjyqtarëve në këtë divizion.

Në lëmine **jo kontestimore**, në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 865 lëndë, gjatë vitit 2023 janë pranuar në punë 320 raste të reja. Në vitin 2023 janë zgjidhur 503 raste apo me efikasitet prej 159%, ndërsa kanë mbetur 676 lëndë aktive.

Në lëmine **përmbarimore**, në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 2,522 raste, gjatë vitit 2023 janë pranuar në punë 1,364 raste të reja. Në vitin 2023 janë zgjidhur 2,183 raste apo me efikasitet prej 160%.

Divizioni i **kundërvajtjes**: në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 2,012 raste, gjatë vitit 2023 janë pranuar në punë 2,224 raste të reja. Në vitin 2023 janë zgjidhur 2,205 raste apo me efikasitet prej 99%.

1.2 Gjykata Themelore – Dega në Suharekë

Gjykata Themelore – dega në Suharekë, aktualisht ka katër (4) Gjyqtarë, të ndarë nga dy (2) gjyqtarë për divizionin penal dhe civil, kurse lëndët nga divizioni i kundërvajtjes gjykohen nga gjyqtarët e divizionit penal. Ndërsa edhe dy (2) gjyqtarë që janë në fazën përfundimtare të trajnimit fillestar janë të caktuar në këtë degë të gjykatës dhe pritet që gjatë vitit 2024 të ndikojë në efikasitet më të mirë dhe shpërndarje të barabartët të punës.

Gjykata Themelore – dega në Suharekë, në bazë të të dhënave të përpunuara statistikore, në përgjithësi ka treguar një efikasitet prej 93% që është mjaft pozitive marrë parasysh mungesën e gjyqtarëve që ka pasur dhe numrin e madh të lëndëve të reja të pranuar në punë.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal: në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 431 raste, gjatë vitit 2023 janë pranuar në punë 403 raste të reja. Në vitin 2023 janë zgjidhur 389 raste apo me efikasitet prej 97%.

Ky departament në vazhdimësi ka një efikasitet të lartë të zgjidhjes së rasteve, kjo tregon një angazhim të mirë të gjyqtarëve, qoftë në caktimin e seancave apo në përpilimin e vendimeve brenda afateve ligjore.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil:

Në lëminë **kontestimore** në fillim të vitit 2023 janë trashëguar 2,632 lëndë, gjatë vitit 2023 janë pranuar 1,354.

Kjo është sfidë jashtëzakonisht e madhe menaxhimi i një numri kaq të madh të lëndëve, mirëpo gjyqtari mbikëqyrës ka arritur me sukses të menaxhojë këtë divizion, pasi që i njëjti edhe gjykon dhe ndarja e barabartë e lëndëve ka qenë një hap i suksesshëm për trajtimin e rasteve.

Gjatë vitit 2023 janë zgjidhur 894 lëndë të natyrës kontestimore, apo me një normë efikasiteti prej 66%. Kjo tregon një trajtim të mirë të lëndëve, përkundër faktit se janë vetëm dy (2) Gjyqtarë të lëmisë civile dhe numri të mardh të rasteve të reja të ardhur anë punë.

Në lëminë **jo kontestimore**, gjatë vitit 2023 ka një efikasitet prej 82% të zgjidhjes së lëndëve. Në fund të vitit 2023 kanë mbetur 99 lëndë të pazgjidhura.

Në lëminë **përmbartimore**, gjatë vitit 2023 ka pasur një efikasitet prej 58% të zgjidhjes së lëndëve. Në fund të vitit 2023 kanë mbetur 1,330 lëndë të pazgjidhura. Konsiderojmë që gjatë vitit 2024 ky numër brenda 6 muajve do të jetë shumë më pak, si rezultat i angazhimit të dy (2) gjyqtarëve të ri.

Divizioni i **kundërvajtjes**: gjatë vitit 2023 ka treguar një efikasitet prej 217%.

1.3 Gjykata Themelore – Dega në DRAGASH

Gjykata Themelore – dega në Dragash, ka dy (2) gjyqtarë të angazhuar. Mbikëqyrësi i cili trajton lëndë penale edhe në Gjykatën Themelore në Prizren, dhe një (1) gjyqtare e cila trajton lëndë të të gjitha natyrave.

Gjykata Themelore – dega në Dragash, në bazë të të dhënave të përpunuara nga sistemi SMIL, ka një efikasitet të ngjashëm në vazhdimësi, mirëpo ky rezultat mund të ketë përmirësim me një angazhim dhe përkushtim gjatë vitit 2024.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal: në fillim të vitit 2023 ka trashëguar 257 raste, gjatë vitit 2023 janë pranuar në punë 101 raste të reja. Në vitin 2023 janë zgjidhur 50 raste apo me efikasitet prej 50%.

Në fillim të vitit 2024, do të ketë një vëmendje dhe angazhim të shtuar për të trajtuar lëndët në divizionin penal.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil:

Në lëminë **kontestimore** në fillim të vitit 2023 janë trashëguar 1,043 lëndë, gjatë vitit 2023 janë pranuar 344 lëndë. Duke marrë parasysh që lëndët e kësaj natyre i trajton vetëm një Gjyqtare,

kjo përbën sfidë në vete menaxhimi dhe trajtimi i të gjitha këtyre rasteve, andaj do të shikohet mundësia e riorganizimit gjatë vitit 2024, me qëllim të trajtimit të këtyre rasteve.

Gjatë vitit 2023 janë zgjidhur 133 lëndë të natyrës kontestimore, apo me një normë efikasiteti prej 39%.

Në lëminë **jo kontestimore**, gjatë vitit 2023 ka një efikasitet prej 111% të zgjidhjes së lëndëve. Në fund të vitit 2023 kanë mbetur 79 lëndë të pazgjidhura.

Në lëminë **përmbartimore**, gjatë vitit 2023 ka pasur një efikasitet prej 342% të zgjidhjes së lëndëve. Në fund të vitit 2023 kanë mbetur 278 lëndë të pazgjidhura. Në këtë lëmi janë zgjidhur 462 lëndë, dhe është rezultat i mirë.

Divizioni i **kundërvajtjes**: gjatë vitit 2023 ka treguar një efikasitet prej 99%. Në fund të vitit 2023 kanë mbetur 85 lëndë të pazgjidhura.

1.4 Raporti për moshën e lëndëve në pritje

Raportimi për këtë natyrë të lëndëve bëhet duke u bazuar në Planet strategjike për trajtimin e lëndëve më të vjetra se 24 muaj.

Në bazë të të dhënave të përpunuara nga SMIL, për moshën e numrit të lëndëve në pritje, pritje në Gjykatën Themelore në Prizren dhe degët Suharekë & Dragash, është si në vijim:

Gjykata Themelore Prizren

Departamenti për Krime të Rënda – Nga 143 lëndë në pritje, janë 33 lëndë më të vjetra se dy vite apo 22%.

Departamenti për të MITUR – Nga 43 lëndë në pritje, janë 14 lëndë më të vjetra se dy vite, apo 40%.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal – Nga 2,308 janë 751 lëndë më të vjetra se 24 muaj, apo 32%.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil – Nga 8,951 lëndë Kontestimore, më të vjetra se 24 muaj janë gjithsej 2,613 lëndë, apo 29%.

Jo Kontestimore – nga 678 lëndë në pritje, janë 422 lëndë më të vjetra se dy vite.

Përmbartimore, nga 1,701 lëndë në pritje, janë 434 lëndë më të vjetra se dy vite.

Gjykata Themelore – Dega në Suharekë

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal – Nga 505 në pritje, janë 159 lëndë më të vjetra se 24 muaj, apo 32%.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil – Nga 3,074 lëndë Kontestimore në punë dhe aktive, më të vjetra se 24 muaj janë gjithsej 1,075 lëndë, apo 35%.

Jo Kontestimore – nga 99 lëndë në pritje, janë 29 lëndë më të vjetra se dy vite.

Përmbarrimorë, nga 1,390 lëndë në pritje, janë 245 lëndë më të vjetra se dy vite.

Gjykata Themelore – Dega në Dragash

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal – Nga 308 lëndë në pritje, janë 74 lëndë më të vjetra se 24 muaj, apo 23%.

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil – Nga 1,254 lëndë Kontestimore në punë dhe aktive, më të vjetra se 24 muaj janë gjithsej 252 lëndë, apo 19%..

Jo Kontestimore – nga 79 lëndë në pritje, janë 35 lëndë më të vjetra se dy vite.

Përmbarrimorë, nga 278 lëndë në pritje, janë 46 lëndë më të vjetra se dy vite.

1.5 Raporti për anulimin/dështimin e seancave gjyqësore

Gjykata Themelore Prizren

Sa i përket shtyrjes së seancave në bazë të të dhënave të siguruara nga sistemi SMIL në Departamentin për Krime të Rënda, gjatë vitit 2023, janë shtyrë/anuluar 82 seanca gjyqësore, më saktësisht 23 si pasojë e mungesës së të pandehurit, 8 mungesa e dëshmitarit, 15 seanca janë shtyrë/anuluar sipas detyrës zyrtare.

Në Departamentin për të Mitur, gjatë vitit 2023, janë shtyrë/anuluar gjithsej 73 seanca gjyqësore. Më saktësisht 51 si shkak i mungesës së të pandehurit, 10 sipas detyrës zyrtare, dhe seanca tjera për arsye të tjera.

Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjatë vitit 2023, janë shtyrë/anuluar gjithsej 712 seanca. Më saktësisht 507 mosparaqitja e të pandehurit, 40 mungesa e dëshmitarit, ndërsa 88 sipas detyrës zyrtare, dhe pjesa tjetër me kërkesë të palëve në procedurë (pandehurit, mbrojtësit apo prokurorit).

Në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjatë vitit 2023, janë shtyrë/anuluar gjithsej, 152 seanca, 30 për shkak të mos pranimit të ftesës së rregullt të palëve në procedurë, 35 sipas kërkesë së palëve, dhe 55 seanca për pengesa të tjera.

Gjykata Themelore– Dega Suharekë

Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjatë vitit 2023, janë shtyrë/anuluar gjithsej 189 seanca. Më saktësisht 126 mosparaqitja e të pandehurit, 15 mungesa e dëshmitarit, 26

mbledhja e provave të reja nga palët, ndërsa 11 sipas detyrës zyrtare, dhe pjesa tjetër me kërkesë të palëve në procedurë (pandehurit, mbrojtësit apo prokurorit).

Në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjatë vitit 2023, janë shtyrë/anuluar gjithsej, 75 seanca, 26 për shkak të mos pranimit të ftesës së rregullt të palëve në procedurë, 29 sipas kërkesë së palëve, dhe të tjerat për arsye të tjera.

Gjykata Themelore – Dega Dragash

Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjatë vitit 2023, janë shtyrë/anuluar gjithsej 47 seanca. Më saktësisht 32 mosparaqitja e të pandehurit, 12 mungesa e dëshmitarit, dhe pjesa tjetër me kërkesë të palëve në procedurë (pandehurit, mbrojtësit apo prokurorit).

Në Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjatë vitit 2023, janë shtyrë/anuluar gjithsej, 166 seanca, 62 për shkak të mos pranimit të ftesës së rregullt të palëve në procedurë, 30 sipas kërkesë së palëve, 9 sipas detyrës zyrtare, dhe 39 seanca për pengesa të tjera.

Këto statistika janë marrë nga Sistemi SMIL i cili i përpunon të gjitha shënimet të cilat gjyqtarët dhe zyrtaret që punojnë me gjyqtarë i evidentojnë në këtë sistem.

1.6 Raporti për gjyqtarët dhe stafin administrativ 2023 dhe 2024

Gjykata Themelore në Prizren, e fillon vitin 2024 me një numër prej 37 Gjyqtarësh:

Gjykata Themelore Prizren, 31 Gjyqtarë

- 5 Departamenti për Krime të Rënda (së bashku me Kryetaren e Gjykatës).
- 2 gjyqtare në Departamentin për të Mitur
- 7 gjyqtar në Divizionin Penal
- 3 Kundërvajtje
- 10 Civile
- 1 gjyqtar Përmbarimore
- 2 gjyqtar të ri (njëri do të caktohet në divizionin penal dhe njëri në divizionin civil)
- 1 gjyqtar i ri i sapo dekretuar

Gjykata ka 20 Bashkëpunëtor profesional

Gjykata Themelore Suharekë – 6 Gjyqtarë

- 2 Civile
- 2 Penale (që kryejnë lëndë të Kundërvajtjes)
- 2 Gjyqtarë të ri të cilët pritet të angazhohen në Divizionin Civil.

Gjykata nga 5 bashkëpunëtor profesional nga Janari i 2024 do të mbetet vetëm me dy (2), për shkak të lëvizjeve të bashkëpunëtorëve (avancime dhe pushime më të gjata).

Gjykata Themelore Dragash

- 2 Gjyqtarë, që punon në të gjitha lëmitë

Gjykata ka 2 bashkëpunëtor profesional

Gjatë viti 2023 është pensionuar një (1) gjyqtarë i kundërvajtjes dhe janë pensionuar 5 zyrtarë administrativ.

Gjatë vitit 2024 do të pensionohen 3 gjyqtarë, dy (2) nga divizioni penal, një (1) divizioni kundërvajtjes. Gjithashtu pensionohen edhe katër (4) zyrtarë të stafit administrativ.

Gjykata Themelore në Suharekë ka mungesë të stafit administrativ, gjatë vitit 2022 janë pensionuar tre (3) zyrtar, ndërsa ka dhënë dorëheqje një (1) zyrtar, gjatë 2023 pensionohen edhe dy të tjerë. Ndërsa janë së paku dy zyrtar të cilët për arsye shëndetësore nuk arrijnë të punojnë me kapacitet të plota (marrim pushime mjekësore të detyrueshme apo edhe pa pagesë).

Andaj, është e domosdoshme, që menjëherë në tremujorin e I-rë të vitit, Sekretariati i KGJK-së, të aprovoj kërkesën e Gjykatës Themelore në Prizren dhe degës së Suharekë, për plotësimin e vendeve të punës që janë të lira, me qëllim të mbarëvajtje së punës dhe efikasitetit, e sidomos të ofrimit të shërbimeve profesionalizmit ashtu që secili i punësuar të mbuloj sektorin e tij/saj.

Në Gjykatën Themelore në Prizren të plotësohen pozitat sipas organogramit, Pozitat e udhëheqësve të zyreve, të mbikëqyrësve, shtëpiak, recepcionist, përkthyes, vozitës dhe pozita të tjera sipas nevojave të përditshme për punë.

1.7 Raporti mbi lëndët për procedurat SMIL - SQEP

Qëndrueshmëria e SMIL dhe SQEP është stabile. Vazhdojnë të futen të dhënat në momentin që ato i plotësojnë kushtet për t'u regjistruar në SQEP dhe atë duke respektuar afatet ligjore për futjen e të gjitha të dhënave të duhura. Ka lehtësuar procesin e punës sa i përket dhënies së një numri të madh të certifikatave të përditshme, pas kërkesave të shumta. Në të njëjtën kohë është arritur rehabilitimi ligjor i shumë të dënuarve. Ka arritur të ngrisë efikasitetin në punë dhe është 100% funksional dhe i përditësuar. Në muajin nëntor ka hyrë në fuqi dhënia e certifikatave pa pagesë e cila është duke u zbatuar pa kurrfarë pengesë.

Të gjithë gjyqtarët dhe stafi administrativ janë udhëzuar që SMIL të jetë programi kryesor dhe i vetmi për punë, dhe secili të përmbush në plotësi detyrat në kuadër të programit SMIL.

Tashmë pas një punë intensive në fund të vitit 2023 kur është bërë barazimi i numrit të lëndëve në sistem dhe lëndëve të cilët janë fizikisht tek gjyqtarët, programi SMIL është 100% në funksion sa i përket Gjykatës Themelore në Prizren.

Gjykata të gjitha të dhënat, statistikat dhe raportet e punës i paraqet duke u bazuar vetëm në këtë program .

Bazuar në Strategji për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë, Standardet e CEPEJ, gjykata në formë të rregullt raporton në KGJK, për raporte statistikore. Të gjitha informacionet dhe raportet statistikore përpunohen duke shfrytëzuar vetëm programin SMIL dhe ato raporte që i ofron ky program. Në fund të tremujorit të katërt është bërë barazimi i të dhënave statistikore në të gjitha lëmi dhe tani kemi një pasqyrë reale të gjendjes së lëndëve në gjykatë dhe ecurinë e tyre.

Menaxhimi i dosjes në mënyrë fizike ka qenë pjesë e raportimeve tremujore në KGJK. Është ndërmarr iniciative e veçantë për menaxhim të dosjeve dhe ka përmirësim të dukshëm në këtë drejtim dhe janë mbajtur takimet të veçanta me administratoret, shëf i ZML-së, mbikëqyrëset e zyrave, referentet dhe zyrtaret ligjor ku janë identifikuar të gjitha pengesat në secilën lëmi dhe janë ndërmarr veprime konkrete për eliminim të të njëjtëve. Në tremujorin e tretë janë eliminuar të gjitha pengesat dhe dosjet menaxhohen dhe përditësohen në vazhdimësi në baza ditore.

Është duke u zbatuar Udhëzuesi i KGJK –së për procedurë të dërgimit të shkresave të gjykatës, por kemi pengesa për shkak se kemi mungesë të dy dorëzuesve (një dorëzues është pensionuar kurse njëri ka dhënë dorëheqje), si dhe është e nevojshme përmirësimi i kushteve të punës për dorëzuesit e gjykatës. Mirëpo, me shpërndarjen e barabartë të punëve për dorëzuesit është duke u mbuluar puna dhe aktiviteti, si dhe shfrytëzojmë edhe mjete alternative (emaili i gjykatës), për njoftime të tjera me rëndësi dhe me qëllim të efikasitetit. Administratorja e gjykatës është në mbikëqyrje të vazhdueshme të punës së dorëzuesve dhe realizimin e punës pa pengesa.

2. Aktivitet e Gjykatës Themelore në Prizren 2023

2.1 Ri funksionalizimi i objektit të Gjykatës për Divizionin Civil

Me të marrë mandatin si Kryetare e Gjykatës Themelore në Prizren në maj të vitit 2022, së bashku me stafin kemi filluar një angazhim të madh për riorganizimin e Gjykatës Themelore në Prizren, sidomos arkivin e gjykatës dhe ri funksionalizimin e një objekti përcjellës të gjykatës, në të cilin ka funksionuar divizioni i kundërvajtjes, i cili objekt është shfrytëzuar vetëm 25% e kapacitetit të tij.

Fillimisht kemi identifikuar të gjitha problemet me arkivin e gjykatës, gjendjen e saj dhe kemi bërë një vlerësim të gjendjes në objektin përcjellës të gjykatës me qëllim të organizimit dhe ndarjes së punëve.

Për rreth dy (2) muaj, në objektin aktual të gjykatës, ka pasur një pastrim total duke filluar nga korridoret e gjykatës ku kanë qëndruar lëndë që prisnin për tu arkivuar dhe zyrat për menaxhimin e lëndëve. Tashmë objekti i gjykatës është i qasshëm për palë dhe të gjitha lëndët janë dërguar nëaArkivë, e cila është ri organizuar dhe është në tërësi funksionale.

Përpos punëve të shumta që janë kryer në objektin aktual të gjykatës, fokusi kryesor ka qenë në objektin përcjellës ku tashmë nga Janari i 2023 në atë objekt po funksionon Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil.

Për disa muaj rresht, kemi pasur edhe vizita nga KGJK dhe Komisionet e ndryshme në veçanti nga Komisioni për Administrimin e Gjykatave, për funksionalizimin e këtij objekti, i cili që nga viti 2010 ishte shndërruar në depo arkivues dhe sendeve që ishin për asgjësim.

Me një angazhim të madh, kemi arritur që pas shumë intervenimeve, pastrimit, riorganizimit të korridoreve të zyrave dhe të sallave të gjykimit, këtë objekt ta funksionalizojmë dhe ta sjellim në gjendjen që është sot.

Tashmë në këtë objekt janë funksionale dy (2) salla të gjykimit, gjashtëmbëdhjetë (16) zyre për gjyqtarë dhe bashkëpunëtor profesional dhe zyrat për staf administrativ, respektivisht, zyra e pranimit dhe zyra për menaxhimin e lëndëve civile.

Funksionalizimi i këtij objekti ka qenë një ndër qëllimet dhe sfida kryesore që kam pasur për vitin 2022, pasi që është dashur angazhim i madh si Kryetare dhe angazhim i stafit administrativ. Tashmë objekti aktual i Gjykatës Themelore në Prizren dhe objekti i Divizionit Civil secili ka hapësirë adekuate të punës dhe me ndihmën e partnerëve (USAID) të njëjtit do të na mbështesin përmes projektit Drejtësia Procedurale, për shenjëzimin e objekteve për qasje sa më të lehtë dhe të mirë të qytetarëve dhe palëve që marrin shërbime në Gjykatën Themelore në Prizren. Gjithashtu, në kuadër të programit për asgjësim të lëndëve të kundërvajtjes janë asgjësuar 300.000 lëndë pas procedurës së evidentimit dhe ruajtjes.

Në dhjetor të vitit 2023, kanë filluar punimet për implementimin e projektit për audio dhe video incizime në katër (4) salla të gjykatës. Gjykata ka ofruar bashkëpunim të plotë dhe hapësirën e nevojshme për implementimin e këtij projekti. Deri më tani janë përfunduar punimet në tre salla të gjykimit dhe vazhdojnë me punimet edhe në sallën e katërt si dhe në zyrën qendrore të mbikëqyrjes dhe vendosjes së aparaturës bazike qendrore.

2.2 Realizimi i planit të punës të KGJK-së.

Gjykata Themelore në Prizren gjatë vitit 2023, ka përmbushur mbi 90% të obligimeve dhe aktivitete që dalin nga plani i punës së KGJK-së dhe që janë aktivitet të gjykatës.

Gjykata Themelore në Prizren, në bashkëpunim me partnerët Justice Activity – USAID, është duke implementuar projektet dhe aktivitetet për përmasimin e qasjes në drejtësi, kur përfshihen rreth 15 (pesëmbëdhjete) aktivitete që duhet zbatuar në disa faza. Gjatë vitit 2023, kemi zbatuar rreth 12 aktivitete, aktivitetet në tërësi, kurse tre (3) aktivitete të tjera, janë në implementim në vazhdimësi.

Në fillim të vitit 2023 janë identifikuar të gjitha lëndët që janë pjesë e planit Strategjik. Nga të gjithë gjyqtarët janë përpiluar raporte të veçanta dhe në vazhdimësi monitorohen rastet që cilat janë me prioritet. Nga muaji mars 2023, të gjitha rastet janë në punë dhe aktive, si dhe caktohen seanca të njëpasnjëshme për rastet sipas kësaj Strategjie. Ne Sstatore të 2023, vlerësohet

se gjyqtarët zbatojnë 100% udhëzimet nga ky plan Strategjik për caktimin e seancave gjyqësore, dhe zgjidhjen e lëndëve sipas udhëzimeve të Planit strategjik

Qëndrueshmëria e SMIL dhe SQEP është stabile. Vazhdojnë të regjistrohen të dhënat në momentin që ato i plotësojnë kushtet për t'u regjistruar në SQEPK dhe atë duke respektuar afatet ligjore për futjen e të gjitha të dhënave të duhura. Ka lehtësuar procesin e punës sa i përket dhënies së një numri të madh të certifikatave të përditshme, pas kërkesave të shumta. Në të njëjtën kohë është arritur rehabilitimi ligjor i shumë të dënuarve. Në muajin nëntor ka hyrë në fuqi dhënia e certifikatave pa pagesë e cila është duke u zbatuar pa kurrfarë pengesë.

2.3 Qasja në gjykatë – Takimet me qytetarët

Qasja e palëve dhe qytetarëve në gjykatë, është jashtëzakonisht e rëndësishme për perceptimin e palëve për punën e gjykatës, andaj edhe gjatë vitit 2023 jemi munduar që me ofrimin e kushteve të mira në objektet e gjykatës, palëve t'iu ofrohet një qasje e lehtë për marrjen e shërbimeve në gjykatë.

Si Kryetare e gjykatës i kushtoj shumë rëndësi komunikimit me publikun dhe palët që marrin shërbime në gjykatë, andaj një herë në muaj gjatë gjithë ditës pres në takim qytetarët dhe palët e interesuara, këtë ditë tashmë e kemi të emërtuar si “Dita e Hapur”. Shqetësimet dhe kërkesa e palëve i adresoj menjëherë tek gjyqtarët apo te stafi administrativ.

Gjithashtu Zyra për Komunikim me Publikun është e qasshme përmes e-mail adresës dhe në baza ditore pranojmë kërkesa nga palët dhe qytetarët, qofshin kërkesa për informata, apo njoftime të tjera, dhe për secilën pyetje apo kërkesë palët pranojnë përgjigje përmes e-mail adresës zyrtare të gjykatës.

Partnerët me të cilët bashkëpunojmë, sidomos në këtë fazë USAID me projektin Drejtësia Procedurale, janë duke ofruar ndihmë dhe bashkëpunim të jashtëzakonshëm për vendosjen e shenjave identifikuese për objektet e gjykatës, duke filluar nga shenjat në hyrje të objektit dhe brenda objektit me qëllim të qasjes sa më të lehtë të qytetareve.

2.4. Raporti mbi publikimin e vendimeve gjyqësore – Komunikimi me media dhe publikun

Publikimi i vendimeve gjyqësore, tashmë është obligim ligjor, andaj Gjykata Themelore në Prizren, publikon të gjitha vendimet që duhet publikuar sipas Udhëzimeve Administrative, brenda afatit ligjor.

Gjatë vitit 2023, janë publikuar gjithsej 4,624 vendime të Gjykatës Themelore në Prizren, dhe degëve në Suharekë dhe Dragash. (apo mbi 1,000 vendime më shumë se gjatë vitit 2022)

Nga ky numër i përgjithshëm 189 vendime janë të Gjykatës Themelore – Dega në Dragash, 441 vendime të Gjykatës Themelore – Dega në Suharekë, kurse 3,994 të Gjykatës Themelore në Prizren.

Ndarë sipas natyrës së rasteve, janë 1,311 vendime të Departamenti të Përgjithshëm – Divizioni Penal, 2,903 vendime të Divizionit Civil, dhe 97 nga Departamenti për Krime të Rënda, kurse 309 vendime Përmbartimore.

Gjatë vitit 2023 shohim rritje të publikimit të lëndëve civile mbi 100%, kjo për shkak të ndryshimit të Udhëzimit Administrativ dhe mundësisë për publikim të vendimeve meritore, por edhe për shkak të rritjes së efikasiteti të zgjidhjes së lëndëve në këtë divizion,

Publikimi i vendimeve padyshim që rrit transparencën, dhe besimin e publiket për punë të hapur, dhe mundëson që palët që kanë interes (media, OJQ-të, por edhe qytetarët për qëllime studimore) që kenë qasje të lehtë në këto vendime.

Gjatë vitit 2023, KGJK ka themeluar Zyrën për Informim, andaj presim që gjatë vitit 2024, të plotësohet edhe pozita e punës së Zyrtarit për Informim, pasi që ajo e Udhëheqësit të Zyrës është plotësuar menjëherë.

Mirëpo, KGJK duhet të ketë parasysh në të ardhmen e afërt, krijimin e një sistemi apo programi i cili do të mundësonte anonimizimin dhe përpunimin e vendimeve, pasi që procesi i publikimit të vendimeve po merr kohë dhe angazhim të stafit. Rritja e numrit të vendimeve të publikuara gjykatës i merr shumë kohë dhe angazhim, sepse në këtë proces duhet angazhuar disa persona dhe duhet punë (e cila është shumë teknike) dhe i merr disa ditë pune, shkarkimi, përpunimi dhe anonimizimi, konvertimi nga word në formatin PDF dhe pastaj vendosja në sistem për publikim përfundimtar.

Gjatë vitit 2023, Zyrtari për Qasje në Dokumente Publike ka përpiluar 29 vendime për qasje në dokumente, në bazë të kërkesave për qasje në dokumente (ky raport i është dërguar KGJK-së, për ta përcjellë në Agjencinë për Informim).

Gjithashtu, nga ana e zyrës për Komunikim me Media dhe Publikun, gjatë vitit 2023 ka pasur mbi 140 përgjigje ndaj kërkesave të mediave për informata apo statistika për Gjykatën Themelore në Prizren dhe janë dërguar 68 Komunikata për caktim të masës së sigurisë apo shpallje të vendimeve gjyqësore për rastet me interes për publikun.

Gjithashtu përmes e-mail adresës zyrtare të gjykatës, nga ana e Zyrës për Komunikim të gjithë qytetarët dhe palët që marrin shërbime në gjykatës marrin përgjigje dhe informacione sipas kërkesa të ndryshme, ashtu që asnjë pyetje apo kërkesë për informatë nga ana e palëve nuk mbetet pa u trajtuar.

2.5 Raporti mbi rastet disiplinore.

Gjatë vitit 2023, Gjykata Themelore në Prizren, Autoriteti Kompetent ka trajtuar nëntëmbëdhjetë (19) raste të ankesave disiplinore.

Të gjitha rastet janë trajtuar brenda afateve ligjore dhe vendimet e Autoriteti Kompetent sipas Udhëzimit të KGJK-së, tashmë publikohen në web faqen e gjykatës.

Konsiderojmë që takimet që unë si Kryetare e gjykatës zhvilloj me palët në “Ditën e Hapur”, kanë ndikuar që palët të mos paraqesin ankesa të papërmbyjtshme, duke i'u referuar mënyrës së zgjidhjes së rasteve, dhe palët janë mjaftueshëm të informuar për rastet se kur mund të paraqesin ankesa për iniciimin e procedurës disiplinore, në mënyrë që të shmangen iniciimi i rasteve për procedurë disiplinore kur palët kanë ankesa për mënyrën e vendosjes.

2.6 Raporti për trajtimin e rasteve të ndërmjetësimit

Gjykata Themelore në Prizren ka të caktuar një bashkëpunëtorë profesionale si referente për ndërmjetësim dhe një praktikant, që ndihmon për trajtimin e rasteve të referuar në ndërmjetësim. (një zyrtar i angazhuar nga USAID, ka përfunduar angazhimin dhe e falënderojmë partnerët e USAID për ndihmon e vazhdueshme).

Në gjykatë ka një zyre të veçantë për trajtimin e rasteve për ndërmjetësim. Në fund të vitit 2023, nuk ka mbetur asnjë lëndë aktive dhe e pa trajtuar në Gjykatën Themelore në Prizren të referuar në ndërmjetësim.

Gjatë vitit janë trajtuar gjithsej 415 lëndë referuar ndërmjetësimit.

Lëndë Penale janë zgjidhur 234 raste, kurse 52 lëndë nuk kanë përfunduar me ndërmjetësim. Lëndë civile, janë zgjidhur 62 raste, kurse 67 lëndë nuk kanë përfunduar me ndërmjetësim.

2.7 Raporti mbi trajtimin e rasteve me interes publik

Në kuadër të trajtimit të rasteve që kanë interes publik, përfshirë rastet e natyrës së Korrupsionit Zyrtar apo lëndëve të shënjestruara për liberalizim vizash, Gjykata Themelore në Prizren ka treguar një kujdes të veçantë dhe është monitoruar në vazhdimësi trajtimi efikas i këtyre rasteve dhe në fate kohore të arsyeshme.

Në Gjykatë, ashtu siç parashihet edhe me procedura ligjore dhe rregullore, gjykimet kanë qenë të hapura, publiku dhe mediat kanë pasur qasje të lirë për përcjelljen e rasteve apo shpalljeve gjyqësore, përpos në rastet kur parashihen kufizimet ligjore.

Në këtë drejtim nuk kemi pranuar ankesa nga palët, mediumet apo OJQ-të që përcjellin punën e gjyqësorit, për kufizime në qasjen e tyre për përcjellën e gjykimeve me interes për publikun.

3. Përfundimi

Gjykata Themelore në Prizren, gjatë vitit 2023 ka arritur që me sukses, t' i adresojë disa probleme dhe sfida që e kanë përcjellë disa vite me radhë, në aspektin organizativ të punës dhe menaxhmentit të gjykatës.

Është bërë riorganizimi i punës në administratën e gjykatës, ashtu që janë identifikuar të gjitha burimet njerëzore. Pastaj është bërë shpërndarja e përgjegjësive për secilin punonjës brenda gjykatës, duke marrë në konsideratë organogramin e gjykatës, pozitat të cilat i mbajnë përgjegjësitë që kanë, pasi që është dashur mbulimi i punëve dhe aktiviteteve të tjera, në mungesë të stafit administrativ dhe mos plotësimit të vendeve të punës.

Gjithashtu, për secilin gjyqtar janë caktuar bashkëpunëtorët profesional, praktikë e cila nuk ka qenë në të kaluarën në Gjykatën Themelore në Prizren.

Pas një angazhimi të madh, është funksionalizuar objekti për Divizionin Civil, me qëllim të ofrimit të kushteve dhe hapësirës adekuate për punë, por edhe hapësirave konkrete për palë dhe qytetarët.

Është bërë barazimi i lëndëve në sistemin SMIL dhe lëndëve të cilët gjyqtarët i kanë në punë në mënyrë fizike dhe e gjithë kjo punë ka sjellë rezultate të cilat janë dhënë në fund të vitit me rritje të përqindjes së zgjidhjes së lëndëve dhe vënia në kontrolle të lëndëve në Divizionin Civil që rrjedhin nga Kontrata Kolektive.

Konsideroj se e gjithë puna e kryer në vitin 2023 është bazë solide për vitin 2024 ku do të vazhdojmë me të njëjtin intensitet dhe do të arrijmë rezultate edhe më të mira dhe do të jemi më të suksesshëm në punën tonë.

*Kryetare e Gjykatës Themelore në Prizren
Shpresa EMRA*